

## AKTI I THEMELIMIT

### I SHOQËRISË ME PËRGJITHËSI TË KUFIZUAR

#### EDEN SOLUTION ALBANIA shpk

Sot, më datë 07/10/2022, në Tiranë

Në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), hartohet ky akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizur **Eden Solution Albania sh.p.k.**

#### KAPITULLI I

**Emri, forma, Selia, Kohëzgjatja**

##### Neni 1

Data e Themelimit dhe Emri

1. Në datën e nënshkrimit të këtij dokumenti themelohet shoqëria **Eden Solution Albania sh.p.k.** (në vijm shoqëria) e ndjekur nga shkurtimi shpk, i cili përcakton formën ligjore të saj si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

##### Neni 2

### Forma ligjore

2. Shoqëria është një entitet ligjor i të drejtës Shqiptare dhe forma ligjore është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), në përputhje me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar).

### **Neni 3**

#### Selia

3. Shoqëria **Eden Solution Albania** sh.p.k e ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Selia e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën “Rruga E Kavajes, 21 Dhjetori, Pallati Gora, Kati 1, Shkalla 1, Tiranë”
5. Me vendim të Asamblesë së Ortakeve, selia e shoqërisë mund të transferohet në një rajon tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, shoqëria ka të drejtë të hapë seli dytësore apo filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo dhe jashtë tij.

### **Neni 4**

#### Kohëzgjatja

6. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
7. Personaliteti juridik i shoqërisë mbaron ditën e çregjistrimit të saj si shoqëri pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **KAPITULLI II**

### **Objekti i veprimtarisë**

### **Neni 5**

#### Objekti i shoqërisë

8. Veprimtaria kryesore:
- a. Shërbime shitje dhe të telemarketingut, marketing online, publicitet dhe reklama, strategji marketingu, konsulencë biznesi;
9. Veprimtari dytësore:
- a. Video maker, grafic design, instalime sisteme kamerash cctv, shërbim printimi, drejtim dhe mirëmbajtje të rrjeteve sociale, krijim dhe administrim software, tregti me shumicë dhe pakicë i produkteve të rrjetit të internetit;
  - b. Import - Export me shumicë dhe pakicë, shitje blerje me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, shitje blerje makinash, shitje blerje pronash të luajtshme dhe të paluajtshme, tregti online.
10. Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.
11. Shoqëria ka të drejtë të ndryshoi objektin e saj në çdo kohë, mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj.

### KAPITULLI III

#### Kapitali Themeltar dhe Kuotat e Kapitalit Themeltar

##### Neni 6

##### Kapitali themeltar

12. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (*njëqind mijë*) lekë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga **ortaku i vetëm** themelues i shoqërisë Z. Emiljano Prifti.

##### Neni 7

##### Ortakët dhe kuotat e kapitalit

13. Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga **ortaku i vetëm** i shoqërisë i cili është Z. Emiljano Prifti, shtetas Shqiptar, il lindur më 29/03/1989, lindur në Fier, dhe me banim në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. ID I90329031Q. Kuotat e zotëruara

prej tij në shoqëri janë përcaktuar si më poshtë:

- a. 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 100.000 (*njëqind mijë*) lekë, e barabartë me 100 % (*njëqind përqind*) pjesëmarrje në kapital, e cila në total përbën 100 % (*njëqind përqind*) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
14. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë.
15. Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
16. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)
17. Shoqëria ka të drejtë të rrisë numrin e ortakëve duke ndryshuar kështu pjesmarren e tyre në shoqëri. Në statut do të përfshihen nene që do të sigurojnë funksionimin normal të shoqërisë edhe në rastet e shtimit të numrit të ortakeve dhe funksionimin e saj.

#### **KAPITULLI IV**

##### **Organet Drejtuese të Shoqërisë**

##### **Neni 8**

##### **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

18. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve (në vijim Asambleja) është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
19. Asambleja miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
20. Kompetencat e Asamblesë janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

##### **Neni 9**

##### **Administratorët**

21. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

22. Mandatin e parë si administratorë do ta ushtroj Z. Emiljano Prifti shtetas shqiptarë, i lindur më 29/03/1989, lindur në Fier, person madhorë me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, me ID nr I90329031Q. Ai do ta ushtroi këtë funksion për një periudhë 5 vjeçare.
23. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.
24. Kompetencat e Administratorit/ve janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

## **KAPITULLI V**

### **Aktiviteti ekonomik – financiar**

#### **Neni 10**

##### Viti financiar

25. Viti financiarë fillon nga data 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.
26. Viti i pare fillon nga data e krijimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 Dhjetor.

#### **Neni 11**

##### Pasqyra e pozicionit financiar

27. Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në dt. 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatit ekonomik (fitim – humbje) dhe inventarin e shoqërisë.

## **KAPITULLI VI**

### **Dispozita përfundimtare**

#### **Neni 12**

##### Hyrja në fuqi

28. Ky akt themelimi hyn në fuqi në ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të

Biznesit, Tiranë, në këtë ditë shoqëria tregtare **Eden Solution Albania** sh.p.k njihet edhe si person juridik.

29. Akt Themelimi u hartua në dy kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

30. Ortaku themelues lexoi dhe nënshkroi me vullnetin e tij të lirë dhe pa vërejtje këtë Akt themelimi.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË**  
**EDEN SOLUTION ALBANIA sh.p.k.**

**EMILJANO PRIFTI**

